



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
BASHKIA DURRËS

PROJEKTVENDIM

NR. _____, DATË _____ 2020

PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË AMBJENTIT, ME VENDODHJE NË KATIN ZERO TË ISH REPARTIT TË URT-SË, ME NR. PASURIE 2/423, ZK 8513, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 602 M² (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 578 M² DHE SIP. FUNKSIONALE 24 M²), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 10 VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, nenit 801 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “Për Qiranë”, sipas Relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, Kryetari i Bashkisë, i propozon Këshillit Bashkiak,

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin për dhënien me qira të ambjentit, me vendodhje në katin zero të ish repartit të URT-së, me nr. pasurie 2/423, ZK 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 602 m² (nga kjo sip. ndërtimi 578 m² dhe sip.funksionale 24 m²), pronë e bashkisë Durrës, për një afat 10 vjet, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.
2. Ngarkohet Drejtoria Ligjore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
BASHKIA DURRËS

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____/____/ 2020

RELACION

PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË AMBJENTIT, ME VENDODHJE NË KATIN ZERO TË ISH REPARTIT TË URT-SË, ME NR. PASURIE 2/423, ZK 8513, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 602 M² (NGA KJO SIP. NDËRTIMI 578 M² DHE SIP. FUNKS. 24 M²), PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT 10 VJET, NËPËRMJET PROCEDURËS SË KONKURRIMIT.

PARA KËSHILLIT BASHKIAK

KËTU

Të nderuar këshilltarë!

Projektvendimi që po ju paraqesim për miratim ka për qëllim fillimin e procedurave për dhënie me qira, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, të ambjentit, me vendodhje në katin zero, të ish repartit të URT-së, me nr. pasurie 2/423, ZK 8513, me sipërfaqe të përgjithshme 602 m² (nga kjo sip. ndërtimi 578 m² dhe sip. funks. 24 m²), pronë e bashkisë Durrës, për një afat 10 vjet.

Pasuria që kërkohet të jepet me qira, është pjesë e ndërtesës me emërtimin reparti URT-së. Që nga viti 2000 e deri më sot kjo ndërtesë i ka kaluar në administrim bashkisë Durrës, e më pas me VKM –në nr. 536, datë 01.05.2008, kjo pasuri ka kaluar në pronësi të bashkisë, për t’u përdorur për ushtrimin e funksioneve të veta. Që nga kjo periudhë e deri më sot ambjenti objekt shqyrtimi është përdorur nga të tretët, Fasoneri, nëpërmjet kontratës së qirasë, me afat përdorimi 5 vjet. Aktuaqlisht kjo kontratë ka mbaruar dhe subjekti i është drejtuar me kërkesë institucionit të bashkisë për të përsëritur kontratën e qirasë.

Nisur nga fakti se sipërfaqja e këtij ambjenti që kërkohet është mbi 200 m², të drejtën për t’u shprehur si për dhënie me qira, ashtu dhe për afatin e përdorimit 10 vjet, e ka këshilli bashkiak, ndaj i drejtohem këtij Këshilli për t’u shprehur me vendim. Këtë të drejtë jua jep VKM-ja nr.54, datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, i cili përcakton se “... Pasuritë shtetërore u jepen të tretëve, duke u transferuar të drejtën e përdorimit me qira ose enfiteozë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit... Pasuritë shtetërore, që jepen me qira janë: ndërtesat, sipërfaqet funksionale (jo nën ndërtesë), trualli i lirë...

Organi, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore jep me qira sipërfaqe mbi 200 m², deri në 20 vjet....”.

Ndërsa ligji organik i vetëqeverisjes vendore në paragrafin *për të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë* përcakton se “... njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë. Ato fitojnë, shesin dhe japin në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tyre, si dhe ushtrojnë të drejta të tjera, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj...”.

Neni 54 i ligjit “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, gërma “e”, përcakton se Këshilli bashkiak “... miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve... Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit...”.

Nëse do të merret vendim për miratimin për dhënien me qira të pasurisë së sipërshënuar mendojmë se do të zgjidhen dhe këto probleme:

- Minimizon sadopak papunësinë.
- Shton të ardhurat në buxhetin e bashkisë.
- Përmirëson objektin nga investimi i pritshëm që do të kryhet nga subjekti gjatë ushtrimit të aktivitetit.
- Ruan objektin nga degradimi (shkatërrimi) si rezultat i mospërdorimit.